

8559

V E N D I M

PER

RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIKE.

Une, gjyqtaria, Donila Copo ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes, sot me daten 1.2.1995, morra ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi, NAMIK NEVRUZ HAJRO, me anen e te ciles kerkon rregjistrimin e personit juridike te Shqerise Tregtare Private " ELIPS 94" SHPK, dhe :

K O N S T A T O V A :

Se, kerkesa e tij eshte e mbeshtetur ne nenin 5 te Ligjes Nr.7512, da te 10.8.1991, si dhe ne Ligjin NR.7638, date 19.11.1992 " Mbi shoqerite tregtare", prandaj dhe duhet te pranohet.

Aktiviteti qe do te ushtroj Shoqeria do te jete ne fushen e :

Projektiveve, ndertimeve civile deri ne dy kate, ne zbatim, punime dheu, murrature, betoni, b/arme, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, e tje. Ujsjellsa, rruge, kanalizime, impiante vaditese, sisteme hidraulike e sherbim komunal, si dhe EKSPORT IMPORTE te mallrave te te gjitha llojeve.

Aktiviteti qe do te kryej Shoqeria nuk ka asnje pengese ligjore dhe si i tille duhet te pranohet.

P E R K E T O A R S Y E :

Ne mbeshtetie te nenit 5 te Ligjes Nr.7512, date 10.8.1991, si dhe te ligjes Nr.7638, date 19.11.1992 " Mbi shoqerite tregtare",

V E N D O S A :

Rregjistrimin e personit juridik te Shqerise Tregtare Private me pergjegjesi te kufizuar " ELIPS 94" SHPK, kerkuar nga zoti NAMIK NEVRUZ HAJRO, per te ushtuar aktivitetin tregetar privat ne fushen e :

Projektiveve, ndertimeve civile, deri ne dy kate, ne zbatim, punime dheu, murrature, betoni, b/arme, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, e tje. Ujsjellsa, rruge kanalizime, impiante vaditese, sisteme hidraulike e sherbim komunal, si dhe EKSPORT IMPORTE te mallrave te ndryshme te te gjitha llojeve.

Selia e Shqerise ndodhet ne fshatin Libonik te Korçes, dhe se ajo do te kete nje kohe zëjatie prej 20 vjetesh.

Kapitali i Shqerise eshte 100.000 leke, i derdhur nga ortakut e vepruesit dhe Administratori i saj, nga zoti NAMIK HAJRO.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

G J Y Q T A R E

Donila Copo

Copo

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
NR. 8559/1\_\_\_\_\_

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me daten 28.07.1995 une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga ;

Kerkuesi Namik Hajro, i cili kerkon te behen shtese objekti ne shoqerine ELIPS 94 SHPK dhe ;

K O N S T A T O V A ;

Me vendimin nr.8559, date 01.02.1995 eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94" SHPK me ortak e administrator Namik Nevruz Hajro, me kapital 100.000 leke, me seli ne Korce dhe me objekt veprimtarie ne fushen e projektiveve e ndertimeve civile etj. tregti me shumice e pakice.

Me vendimin e Asamblese se ortakeve te date 26.07.1995 eshte vendosur te behet shtese objekti edhe ne fushen e prodhimeve te materialeve te ndertimit e mallra artistike, shfrytezim dhe permiresim pyjor, perpunim i lendes se drurit etj. Si dhe shtese ortaku z. Hiqmet Dervishi i cili blen 50 % te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie.

Ne baze te nenit 33/e cmoj se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar;

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1995 Per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses se bere nga administratori i shoqerise "ELIPS 94" shpk Namik Hajro per shtese objekti dhe te depozitohet vendimi i ortakut te vetem ku ben fjale edhe per shtese ortaku z. Hiqmet Dervishi . Me vendimin e asamblese eshte vendosur edhe 50 % te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie i kalojne ortakut te ri z. Hiqmet Dervishi duke u bere ndryshimet perkatese ne Skenden e Regjistrin te kesaj shoqerie me numer rendor 2, ne kollonen e dyte, germa b, si dhe ne kollonen 3 , 4, duke u ndare ndryshimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.  
Tirane, me 27.07.1995

G J Y Q T A R E  
/\_Florina Tegu/  
7576

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE  
Nr 1379/4 vendimit

**V E N D I M  
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M**

Sot me daten 24/10/2002 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane  
Mirëza Celo 1, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi  
te kufizuara "ELIPS-94" shpk me ortak dhe Administratore e Pergjithshem Z. Namik  
Hajro: per depozotimin e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise shoqerise,

**V E R E J :**

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.8559. date 01.02.1995 eshte themeluar  
shoqeria "Elips 94" shpk, me ortak te vetem Namik Nevruz Hajro, dhe me objekt ne  
fushen projektive, ndertimeve civile deri ne dy kate, ne zbatim, punime dhe  
murature, betoni, b/arme , ndertime civile, industriale, turistike bujqesore  
eteje. Ujsjellsa, rruge kanalizime, impiante vaditese, sisteme hidraulikee sherbim  
komunal si dhe import-eksport te mallrave te mallrave te ndryshme te te gjitha  
llojeve. Tregeti me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme.

Ne mbeshetje te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" me  
vendimet : 1. Vendimi i Ortakeve te Shoqerise date 11.09.2002.

2. Vendimi i ortakut te vetem date 18.10.2002.

3. Kontrata e shitjes se kuotave Nr. 1781/Rep, 446/Kol date 11.09.2002.

me vendimin e dates 19.10.2002 kane vendosur :

1. Transferimin e e kuotave te kapitalit me ane te shitjes nga Z. Hiqmet Devishi tek Namik  
Hajro duke mbetur ky i fundit ortak i vetem ne shoqeri.

2. Shtesen e objektit te veprimtarise se shoqerise nga ortakut dhe administratori i vetem i  
shoqerise edhe ne : *Prodhim pijesh alkolike dhe freskuese ne baze te lejes Nr. 99 date  
01.10.2002.*

\*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane me  
objekt: Miratimin e largimit te Hiqmet Dervishi nga shoqeria dhe shitjen e kuotave te tij  
ortakut tjetër Z. Namik Hajro dhe shtese te objektit te veprimtarise se shoqerise sipas  
lejes perkatese.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne  
Ligj dhe si e tille te pranohet.

**PER KETO ARSYE**

Ne mbeshetje te Ligjit Nr. 7667 date 28 janar 1993

**V E N D O S A**

\*Pranimin e kerkeses.

\*Depozitimin e kerkeses dhe dokumentave te paraqitura nga shoqeria "ELIPS-94" shpk  
Tirane duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 3, kollona 4/c e  
kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**G J Y Q T A R E**



AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJSI TË KUFIZUAR ME EMERTIMIN " ELIPS '94 "

- SH .P .K . KORÇË

Set më 10 Janar 1995 i nënshkruari Namik Nevruz Hajro, i biri Selimes me datë lindje 10 Nëntor 1952 në Grabockë dhe banues në Libenik Korçë me vullnet të lirë vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjisi të kufizuar për ndërtim, projektim dhe ekspert - impert me emertimin " Elips '94 " sh.p.k. Korçë.

Neni 1

I lartpërmenduari në këtë akt shpreh vullnetin e tij në mënyrë të lirë e të plotë për krijimin e shoqërisë me përgjegjisi të kufizuar, veprim ky që mundëson zhvillimin e aktivitetit ndërtues, projektues dhe ekspert impert privat në të gjithë teritorin e Republikës të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë private do të jetë: - Projektim ndërtimesh civile deri në dy kate, Në zbatim - Punime dheu, murature, betoni, b/arme ndërtimesh civile, industriale turistike, bujqësore etj. Ujësjellës rrugë kanalizime, impjante vaditëse, sisteme hidraulike e shërbim komunal dhe ekspert imperte të mallrave të ndryshme.

Neni 3

Kapitali fillestarin që do të investohet nga ertaku i vetëm në formën e mjeteve të zhirosështë për 100000 lekë

Neni 4

Afati i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë për 20 vjet, nga data e miratimit të saj.

Neni 5

Emertimi i shoqërisë do të jetë " ELIPS '94 " SH.P.K. KORÇË.

Neni 6

Shoqëria do të ketë vulën e saj me emblenë të përcaktuar nga ertaku i vetëm .

Neni 7

Të ardhurat që do të realizohen nga veprimtaria private e shoqërisë i përfiten ertaku i vetëm i saj.

Neni 8

Administratori i shoqërisë private "ELIPS '94 " SH.P.K. KORÇË do të jetë Z.Namik Hajro, Drejtues Teknik Z.Mysret Aze dhe Drejtues administrativ z.Riqmet Dervishleri (që të dy të punsuar)

Neni 9

Selia e SH.P.K. "ELIPS '94" do të jetë në fshatin Libenik, rrethi Korçë.

Neni 10

Shoqëria do të ketë llogarinë e saj bankare (Rjedhëse) pranë degës së

Banorës Tregëtare Korçë. Sheqëria ka të drejtë të bëhet antare e dhënës  
tregëtisë kundrejt rregullimit ligjer.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e ortakut të vetëm, organizimi i sheqërisë,  
marahëniet me personat juridikë e fizikë, vëndas ose të huaj, me organet  
shtetërore apo organizma të ndryshme shprehën në statutin e sheqërisë,  
akt i cili sëbashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentacionin  
bazë të veprimtarisë së saj që sëbashku me legjilacionin në fuqi  
shërbejnë për rregullimin e veprimtarisë dhe të marahënieve të saj.

Neni 12

Sheqëria ka të drejtë të punësojë për nevojat e saj punonjës e  
specialistë të ndryshëm mbi bazën e një kontrateje individuale e  
kollektive sipas Ligjit "Për marahëniet e punës" ku të parashikohen  
lloji i punës, vendi, koha e punës dhe e pushimit, kushtet e punës,  
shpërblimi i punës dhe mënyra e tij, sigurimi i punonjësve, dhe detyrime  
reciproke të palëve.

Neni 13

Të gjitha mesmarveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së  
sheqërisë, me punonjës, persona juridikë e fizikë, vëndas ose të huaj  
në qoftë se nuk zgjidhen me mirëkuptim ato do të zgjidhen me  
Gjykatë.

Neni 14

Akti i themelimit të sheqërisë redaktohet, lexohet nga themeluesi  
i cili pasi shpreh pëlqimin se është dakort me përmbajtjen e tij  
e nënshkruan pa vrejtime e me vullnet të lirë .

ORTAKU THEMELUES  
NAMIK NEVUZ HAJRO

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA POGRADEC  
NOTERE DRITA PAPI  
Nr 1447 Rep  
Nr 807 Kol

VERTETIMI NËNSHKRIMI

Sot me date 31/1/1995 u paraqiten para meje notere Drita Papi  
personalisht Namiq Nevuz Hajro datlindja 10/mendror 1952 banues  
libonik te rrethit Korçë , me hor i afte per te kryer veprime juridike  
per identitetin e te cilit u sigurova me ane te leter njoftimit perso-  
nal dhe para meje deklaroi se nënshkruoi veten ne aktin e themelimit  
eshte i tij ,vertetoj firmen e tij/

PULL TAKSE  
NOTERIA DRITA PAPI  
Drita Papi  
REPUBLICA E SHQIPERISE  
NOTERIA POGRADEC  
RE SHQIPERISE

S T A T U T I

I SH.P.K. PROJEKTIM - NDËRTIM, EKSPORT - IMPORT " ELIPS 94 "  
ME QËNDËR NË KORÇË .

SH.P.K. Projektim - Ndërtim, Eksport - Import " ELIPS 94 " është firmë private e themeluar nga Namik Hajro i biri i Nevruzit , banues në Libonik të rrethit Korçë dhe me seli në Korçë, dhe do të funksionojë sipas këtij statuti:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Themelohet në Libonik të rrethit Korçë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar " ELIPS 94 " me ortak të vetëm.

NENI 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në fshatin Libonik të rrethit Korçë.

NENI 3

Shoqëria ka të drejtë të paraqitet në qarkullimin civil e merr të drejta e detyrime ligjore mbasi të rregjistrohet në regjistrin e Gjykatës të rrethit të Tiranës dhe pasi të ketë marrë lejen për ushtrimin e profesionit.

NENI 4

Ajo ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj pasi të njoftojë më parë institucionet përkatëse shtetërore dhe mund të hapë filiale në të gjithë njësitë territoriale të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Agjensitë ose filialet krijohen në bazë të legjilacionit të vendit ku ato hapen.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

a- Për projektme :

- Ndërtime civile ( deri në dy kate )
- Brugë
- Ujësjetlla

%%%



b - Pë zbatim :

- Punime dheu, murature, betoni, b/arme të zakonshme, punime shembjesh.

- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to.

- Punime restaurimi.

- Punime të shtresave të rrugëve.

a - Ujësjiellësa, kanalizime, impjante vaditëse.

b - Punime të mbrojtjes së sistemeve hidraulike

- Mirëmbajtje e punime shërbimi të zakonshëm të sistemit komunal etj.

c - Eksport - import materiale e makineri industriale - ndërtimore.

Kjo veprimtari do të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj duke krijuar ortakëri dhe lidhje me shoqëri të huaja.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të shtohet me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 6

Veprimtaria e shoqërisë do të zhvillohet në pajtim me këtë statut dhe normat ligjore, juridike e civile, administrative, tatimore e fiskale të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mban përgjegjësi për detyrimet që lindin në marrëdhëniet me subjektet e tjera fizike e juridike, shtetërore e private dhe përgjigjet me pasurinë e saj. Në çdo rast ai është përgjegjës para ligjeve.

NENI 7

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 20 vjet me të drejtë ndryshimi të afatit.

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të krijojë lidhje të tjera ortakërie ose shoqëri të përbashkët me persona të tjerë fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, në përputhje me legjislacionin përkatës duke ndryshuar ar këtë statut.





neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me embleme përkatëse.

II. KUSHTET EKONOMIKE

neni 10

Veprimtaria e shoqërisë bazohet në kushtet e ekonomisë së tregut duke pasur për qëllim Fitimin. Ajo ndërton gjithë aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit dhe respekton parimin rentabilitetit sigurisë dhe likuiditetit.

neni 11

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të parimeve të llogarisë e kontabilitetit dhe për këtë qëllim nxjerr bilancin e saj.

neni 12

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë në formën e mjeteve qarkulluese dhe 3900000 lekë në formën e aktiveve të qëndrueshme.

Ky kapital prej 3.900.000 lekë është pronë e ortakut të vetëm

neni 13

Kapitali themelor është lirisht i transferueshëm me akte ligjore në trashëgimtarët ligjorë e testamentorë, vetëm me vullnetin e ortakut të vetëm.

neni 14

Ortaku i vetëm ka të drejtë të vendosë për shtimin ese pakësimin e kapitalit themelor të shoqërisë.

neni 15

Shoqëria është pronare e pasurive të lujtshme e të palujtshme të cilat mund të përdoren në funksion të qëllimit të shoqërisë.

Shoqëria mund të blejë pasuri të tjera dhe mund të lerë peng, ose në hipotekë, pasurinë e saj kur e vlerëson të domosdoshme ortakut i vetëm.

neni 16

Shoqëria, për rishtrimin e aktivitetit të saj, krijon fonde përkatës (sipas përcaktimit të kontabilitetit shqiptar) nga fitimet e realizuara ose me financim të ortakut të vetëm.





NENI 17

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë i takon tërësisht ortakut themelues, i cili e disponon atë krejt lirshëm.

III. KONTABILITETI DHE BILANÇI

NENI 18

Shoqëria, për evidentimin ekonomik - financiar të aktivitetit të saj, do të zbatojë planin kontabël të Republikës së Shqipërisë të përcaktuar me ligjin "Për kontabilitetin".

NENI 19

Shoqëria, në bazë të ligjit "Për kontabilitetin", në mënyrë periodike dhe një herë në fund të vitit (31 dhjetor çdo vit) nxjerr bilançin e saj financiar dhe e depoziton atë konform akteve ligjore në institucionet përkatëse.

NENI 20

Pasi bilançi vjetor të jetë miratuar nga eksperti kontabël i shoqërisë, asambleja e firmës mbledhet brenda dy muajve nga nxjerrja e bilançit për miratimin dhe publikimin e tij ose organet shtetërore të autorizuar me ligj.

NENI 21

Ortaku i vetëm, pasi ka miratuar bilançin dhe ka shlyer detyrimet karshi të tretëve, vendos për përdorimin e fitimit të realizuar në drejtim të fuqizimit të shoqërisë, shpërblime, sponsorizime ose veprime bamirëse.

NENI 22

Dokumentat financiare, librat e kontabilitetit, bilançet periodike e vjetorë, çmimet e preventivave, të mallrave e materialeve, të projekteve si dhe analizat e çmimeve përbëjnë sekretin e firmës e si të tilla ato mund të publikohen vetëm me miratimin e ortakut të vetëm në organet shtetërore të autorizuar me ligj për kontroll ose publikim.

Çdo veprim tjetër përbën shkelje të statutit.



NENI 23

Të gjitha pagesat e likuidimet që do të kryhen me të tretët do të bëhen nëpërmjet Degës së Bankës Shtetërore Korçë në llogarinë e SH.P.K. Nr. \_\_\_\_\_

Veprimet financiare në llogarinë Nr. \_\_\_\_\_ që ka shoqëria në Degën e Bankës Shtetërore Korçë do të kryhen me dokumentacionin që përcakton kontabiliteti Shqiptar, të sigluar vetën nga ortaku i vetëm, ose personi i autorizuar prej tij - drejtori administrativ e kundrejt vulës.

NENI 24

Shoqëria mund të kryejë edhe pagesa jashtë Degës së Bankës Korçë, në mënyrë direkte ose nëpërmjet arkës së shoqërisë, me miratim të ortakut të vetëm ose të autorizuarit të tij.

IV. ADMINISTRIMI

NENI 25

Asambleja është organi i vetëm vendimor. Ajo përbëhet nga presidenti i firmës që është ortaku i vetëm, themeluesi i shoqërisë, Drejtuesi Teknik dhe Drejtori administrativ. Vendimet e marra prej saj në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë, janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit. Kjo asamble nuk vendos për kapitalin themelor, fondet dhe fitimin pasi janë kompetencë ekskluzive e ortakut të vetëm.

NENI 26

Asambleja thirret rregullisht në takim pune një herë në muaj ose me kërkesë të një prej antarëve të saj në çdo moment, në një kohë të përshtatshme.

NENI 27

Ortaku i vetëm ka të drejtë të autorizojë me prokurë të veçantë, pa të drejtë anulimi ( të prokurës ) deri në momentin e mbylljes së shoqërisë, persona të tjerë që të drejtojnë aktivitetin e shoqërisë duke i bërë ata bashkëpronarë në kapitalin themeltar, në



fondet, në fitimin e në çdo të ardhur tjetër të kësaj shoqërie duke i kthyer këta nëpërmjet kësaj prokure në ortakë të barabartë në shoqëri me përqindje të caktuar në kapitalin e në fitim për çdo njërin. Nga lëshimi i kësaj prokure ( edhe pa ndryshim statuti për kushte objektive për një periudhë kohe të caktuar nga ortaku i vetëm) të gjithë personat e autorizuar kanë të përbashkët si detyrimet ashtu e të ardhurat deri në ndryshimin e statutit dhe gjithë dokumentave të tjera ligjore që disponon shoqëria.

NENI 28

Shoqëria për drejtimin e aktivitetit të përditshëm organizohet :

1. Drejtori i firmës, që është ortaku i vetëm, dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

2. Drejtori teknik i shoqërisë ,që udhëheq gjithë drejtimin teknik të firmës dhe i paraqet presidentit të firmës të gjithë argumentat e propozimet teknike për kryerjen e aktivitetit. Ai përgjigjet për gjithçka teknike para presidentit të firmës dhe ligjeve të shtetit.

3. Drejtori administrativ udhëheq gjithë aktivitetin e shoqërisë,realizon marrëdhëniet kontraktuale e ekonomike financiare me të tretët dhe me autorizim të ortakut të vetëm mund të përfaqësojë ligjërisht dhe shoqërinë në marrëdhënie me shtetin dhe personat e tjerë fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.

4. Eksperti kontabël zgjidhet nga asambleja çdo vit dhe punon për sistemimin ligjor të gjithë veprimeve ekonomike e financiare në kontabilitet. Ai miraton bilançin financiar të firmës e ja paraqet asamblesë.

V. MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 29

Shoqëria do të punësojë të gjithë personelin drejtues e administrativ, specialistë dhe punëtorë të thjeshtë. Marrëdhëniet e punës rregullohen me këtë statut dhe sipas ligjit "Për marrëdhëniet e punës" në Republikën e Shqipërisë.



NENI 30

Punësimi i punonjësve do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale të punës ku do të përcaktohen :

- kushtet dhe mënyra e punës.
- koha e fillimit, e mbarimit të kontratës, profesioni, sigurimi teknik, mënyra e pagesës, koha e punës ditore, pushimi javor, festat dhe e drejta e grevave dhe ndërprerjes së punës etj.
- detyrimet ndaj shtetit, firmës dhe përgjegjësia materiale dhe kushteve teknike e cilësisë.
- format dhe masa ndaj dëmeve që mund t'i krijojnë firmës.

VI. MBYLLJA E SHOQËRISË DHE LIKUJDIMI

NENI 31

Shoqëria përfundon veprimtarinë e saj me plotësimin e afatit të parashikuar në këtë statut. Ortaku i vetëm mund të vendosë zgjatjen e afatit të përcaktuar në statut ose prishjen e shoqërisë para skadencës së afatit.

NENI 32

Ortaku i vetëm cakton mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke emëruar dhe likujdator sipas fuqisë që ai u jep dhe duke respektuar ligjin për këtë qëllim.

NENI 33

Njoftimi i mbylljes së shoqërisë do të publikohet në një nga gazetatat periodike të caktuara për këtë qëllim, me vendim të ortakut të vetëm ose të organeve shtetërore , në rastet kur falimenton.

NENI 34

Shoqëria fillon likujdimin e saj duke likujduar më parë detyrimet ndaj shtetit, ndaj punonjësve të saj dhe pastaj ndaj të tretëve.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 35

Statuti i SH.P.K. " ELIPS 94 " u nënshkrua nga ortaku i vetëm para noterit të ligjëruar.

ORTAKU THEMELUES  
NAMIK NEVRUZ HAJRO



K E R K E S E

137P

KERKUES : Namik Hajro, i biri Nevruzit dhe Selimes, i dtlindjes 10.11.1952, lindur e banues ne Korçeshatin Libonik, me zotesesi te plote juridike per te vepruar.

OBJEKTI : Kerkoj ndryshimin e statutit te shoqerise duke shtuar ortakun Hiqmet Dervishleri me kapitale 50 % secili dhe objektin e veprimtarise se shoqerise ne baze te ligjit 7667 dt.28.1.1993.

GJYKATES SE RRETHIT  
T I R A N E

Me vendimin Nr.8559 dt.4.2.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94" eshte regjistruar si person juridik. Kerkoj nga kjo gjykate qe te pasqyroje ne regjistrin tregtare ndryshimet ne statutin e shoqerise duke shtuar ortakun Hiqmet Dervishleri ne kuoten 50 % dhe duke shtuar aktivitetin e shoqerise si me poshte :

prodhim materiale ndertimi e mallra artistike, shfrytezim dhe permirsim pyjor, perpunim i lendes se drurit, eksport importi dhe tregtimin e shumice e pakice te te gjitha mallrave industriale, ushqimore, pjese kembimi, konfeksione, makineri e paisje, lende e prodhime drusore, elektronike, elektroshtepiake, materiale ndertimi e hidrosanitare, servis automjeteve dhe linja teknologjike, transport pasagjeresh e mallrash brenda e jashte vendit, urbane, interbubane dhe nderurbane, agjensi turistik informacion biznesi, ndihme juridike dhe ekonomike dhe pasurive te palujtshme, aktivitet ndermjetsimi dhe komisionimi, aktivitet kembimi valutore, aktivitet perfaqesimi te subjekteve vendas dhe te huaj.

Ne baze te ligjit Nr.7667 dt.28.1.1993 kerkoj qe keto ndryshime te pasqyrohem edhe ne regjistrin tregtare te kesaj gjykate.

K e r k u e s i  
Namik Hajro

*Te depozituar  
Lentere  
Dt 29.07.1995  
[Signatures]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE

" N O T E R I A "

NR. 1386

W-447 kal

Tirane, me 27.7.1995

V E R T E T I M

Vertetohet se sot u paraqit para meje noteres i quajturei Namik Hajro i biri Nevruzit dhe Selimes, i dtlindjes 10.11.1952, lindur e ba-

V E N D I M

I ORTAKUT TE VETEM.

Sot me dt.26.7.1995 une ortaku i vetem dhe administrator i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94"

K O N S T A T O V A

"e vendimin Nr.8559 dt.1.2.1995 te Gjykates se Rr thit Tirane jam regjistruar si person juridik ne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94".

Gjate punes sime kerkoj qe ne shoqeri te shtohet edhe nje ortake tjeterHiqmet Dervishleri i cili blen 50 % te kapitalit te shoqerise dhe shtimin e aktivitetit te saj.

Ne keto rrethana ne baze te ligjit nr.7667 dt.28.1.1993

V E N D O S A

1. Shtimin si ortake ne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94" te Hiqmet Dervishlerit i cili blen 50 % te kapitaleve te shoqerise.

2. shtimin e aktivitetit ekonomik te shoqerise ne fushat si me poshte : - prodhim materiale ndertimi e mallra artistike,shfrytezim dhe permiresim pyjor,perpunim i lendes se drurit,eksport importi dhe tregtim me shumice e pakice te te gjitha mallrave industriale,ushqimore,pjese kembimi,konfeksione,makineri e paisje,lende e prodhime drusore,elektronike,elektroshtepiake,materiale ndertimi e hidro-sanitare,servis automjesh dhe linja teknologjike,transport pas-gjeresh dhe mallrash brenda jashte vendit,urbane,interurbane dhe nderurbane,agjensi turistike,informacion biznesi,ndihme juridike dhe ekonomike, per pasuri te palujtshme aktivitet ndermjetesimi dhe komisionimi,aktivitet kembimi valutore,aktivitet perfaqesimi te subjekteve vendas dhe te huaj.

O r t a k u  
Namik Hajro

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE

" N O T E R I A "

NR. 1386 *rey*

*497 led*

Tirane, me 27.7.1995

KONTRATE SHITBLERJEJE.

Tirane sot me dt.26.7.1995

Kjo kontrate shitblerjeje lidhet ndermjet paleve

1. Namik Hajro, i biri Nevruzit dhe Selimes, i dtlindjes 10.11.1952, lindur e banues ne Libonik Korce, me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne rolin e shitesit
2. Hiqmet Dervishleri, i biri Bexhetit dhe Fiderije, i dtlindjes 10.1.1956, lindur e banues ne Pogradec, pagjen nr.5, pallati 184. me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne rolin e bleresit.

Shitesi Namik Hajro i shet bleresit Hiqmet Dervishleri 50 % te kapitaleve te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94" ku bleresi mbas kesaj kontrate shitjeje behet ortak ne kete shoqeri me shitesin. Kjo kontrate firmoset rregullisht nga palet.

Shitesi  
Namio Hajro



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
"NOTERIA"  
NR. 1386

Bleresi  
Hiqmet Dervishleri



Tirane, me 28.7.1995

VERTETIM

Vertetoj se sot u paraqiten para meje noteres te quajturit Namik Hajro dhe Hiqmet Dervishleri per identitetin e te cileve u sigurua nga leternjoftimet qe me paraqiten.

Para meje firmosen kete kontrate shitblerjeje.



V E R T E T I M

Shoqeria "ELIPS 94" me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.8559 dt.1.2.1995 eshte regjistruar si person juridik me administratore Namik "ajro, me kapitale 100 000 lekeme seli ne Libonikte Korces me objekt ne fushen e ndertimit.

Depoziton sot me dt.     .7.1995 prane regjistrin tregtare te Gjykates se Rrethit Tirane keto materiale.

1. Kerkesen drejtuar Gjykates nga administratori i shoqerise per shtimin e ortakut tjetër Hiqmet "ervishleri ne masen 50 % te kapitalit te shoqerise dhe shtimin e objektit te shoqerise ne fushat te percaktuara ne kerkese.

2. Vendimin e ortakut te vetem dt.26.7.1995 per shtimin e radeve te ortakeve dhe objektit te shoqerise.

Keto ndryshime pasqyrohen edhe ne fleten e regjistrin tregtare te Gjykates se Rrethit Tirane.

PER REGJISTRIN TREGTARE  
SEKRETARI  
Luljeta Ilia

Tirane, me 28.7.1995





K E R K E S E

E

94

SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "ELIPS" SHPK, PER TË RREGJIT  
STRUAR SI PERSON JURIDIK



855P

KERKUESI : e NAMIK HAJRO, i biri i Nevruzit, lindur ne Grabocke me 10.11.1952 dhe banues ne Dibonik te Korçes, madhore dhe i afte per te kryer veprime juridike.

OBJEKTI :- Rregjistrimin e personit juridik te Shoqerise Tregetare Private "ELIPS" SHPK ne baze te nenit 5 te Ligjes Nr.7512, date 10.8.1991, e te Ligjes Nr.7638, date 19.11.1992.

P E R P A R A

GJYKATES SE RRETHIT

*Co. Rep. Albania  
10.02.95  
TIRANE*

Ne mbeshtetie te nenit 5 te Ligjes Nr.7512, date 10.8.1991, si dhe te Ligjes Nr.7638, date 19.11.1992 " Mbi shoqerite tregetare", kerkoj te rregjis-  
trophem si person juridik te Shoqerise Tregetare Private "ELIPS" SHPK, per  
te ushtruar aktivitetin tregetar privat ne fushen e :

Projektime ndertimesh civile, deri ne dy kate, ne zbatim, punime dheu, murature, betoni, B/arme, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, e Ujsjellsa, rruge, kanalizime, impiante vadites, sisteme hidraulike e sherbime komunale dhe eksport importe te mallrave te ndryshme.

Kapitali themelor i Shoqerise do te jete 100.000 leke i derdhur nga ortakut i vetem ~~dhe Administratori~~ i saj, nga zoti NAMIK HAJRO

Selia e Shoqerise ndodhet ne fshatin Libonik te Korçes.

Veprimtaria e Shoqerise do te kete nje kohe zgjatje prej 20 vjetesh.

Kerkoj te rregjistrohem si person juridik te Shoqerise se lartpermerdur, kerkese e cila eshte e mbeshtetur ne ligje dhe si e tille duhet te pranohet nga ana e asaj Gjykate.

K E R K U E S I

( Namik Hajro )

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA NOTERISE TIRANE

Nr. 3094/Rep.

1373



V E R T E T I M

Vertetohet se sot me daten 1.2.1995, ne Zyren e Noterise se Tiranes u paraqit, zoti, Namik Hajro, i biri i Nevruzit, lindur ne Grabocke me 10.11.1952 dhe banues ne fshatin Libonik te Korçes, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike, i cili nenshkroj kete kerkese para meje noteres dhe une noteria pasi e gjeta konform vullnetit te tij e vertetova si me posht

NOTERIE

MAREVESHJE  
MIDIS

DEGES BANKES KOMBETARE TREGETARE TE SHQIPERISE  
PERFAQSUAR NGA THOMA SERANI.....

DHE  
PERFAQESUESIT TE SHOQERIA "ELIPS 94" KORCE.....NE  
KRIJIME SIPER  
ZOTIT..NAMIK HAJRO...  
ME OBJEKT

Rregjistrimin juridik te fondeve te depozituara per llogari te  
shoqerise "ELIPS 94" KORCE...ne krijim e siper .

Palet bien dakord si me poshte:  
1.Perfaqesuesi depoziton prane deges se Bankes Kometare  
Tregetare te Shqiperise prej 100.000...lekesh ose.....USD  
per llogari te shoqerise "ELIPS.94".... shoqeri ne krijim e  
siper

Kjo shume do te rrije e bllokuar ne kete llogari jo me teper se  
nje muaj afat brenda te cilit gjykata eshte e detyruar ligjerisht  
te vendose lidhje me kerkesen e plikantit deri sa nga ana e tij  
te paraqitet mdermjet gjithë dokumentacionit te kerkuar nga Banka  
edhe vendi i rregjistrimit ne gjykate .

2.Dega e Bankes Kometare Tregetare te Shqiperise pranon  
depozitim e shumes se mesiprme duke i dhene depozituesit  
,perfaqesuesit ,certifikaten e depozitimit te fondeve me qellim qe  
ta pareqese ate ne gjykaten perkatese .

3.Ne raste se pagesuesi kerkon te terheqe shumen e siperpermendur  
pa paraqitur dokumentacionin e kerkuar e siper duhet te ktheje  
mbrapsht certifikaten origjinale qe i eshte dhene atij er te  
paraqitur ne gjykate .

4.Per sherbimin qe Banka dte kryeje do te zbatohen komisionet ;  
a.500 lek per SH.P.K. me kapital teresisht shqipetar dhe  
b.50 USD per shoqerite e pershketa SH.P.K me kapital te huaj  
pavaresisht nga raportet qe kane perqdyet e kapitalit ndaj  
partnereve.

5. Kjo mareveshje nenskruhet ne dy kopje prej te cilave secila  
nga palet merr nga nje.

Korce me 27. JANAR 1995

PERFAQESUESI  
( NAMIK HAJRO )

DEGA B.K.T.SH.KORCE  
( THOMA SERANI )

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA KOMBETARE TREGETARE  
DEGA KORCE

Stamp: 052-A  
27 1-  
DEGA E BANKES SE  
SHITETIT KORCE

C E R T I F A T E 76/II4/OI

NAMIK HAJRO te kesaj certifikate Vertetojme se  
.....ka depozitur prane Bankes sone shumen prej 100.000...  
lekesh ose .....USD.Ky depozitim benet per efekt te derdhjes se  
kapitalit fillestar te shoqerise "ELIPS.94"...(ne krijim e siper)

KORCE ME 27/OI/1995

DREJTORI  
Thoma Serani

Stamp: 052-A  
27 1-  
DEGA E BANKES SE  
SHITETIT KORCE

Mod. 7

MANDATARKËTIMI

(E brendshme)

Nr. 009276

LEK 100.000.

2

Lekë

NJEQINDMIJE.

Lekë

Me urdhër NAMIK HAJRO

Në kredi SHOQËRIA " ELIPS 94 " KORÇË

Numri i llogarisë 76/II4/01

Për NGURTËSIM FONDESH PËR SHOQËRINË " ELIPS 94 " NË KRIJLA E SIPËR.

Vëndi KORÇË Datë JANAR 1995

KOMISI Lekë 100.

Lekë

Lekë

Sportelisti

13/02/95

Vula e nënshkrimit

e bankës

Shënim: Dëftesa pa nën-përgjegjësi i sportelit dhe vulën përkatëse nuk është e vlefshme

DEGA E BANKËS SE SHËNIM: KRIJLA

BANKA KOMBËTARE TREGTARE E SHQIPËRISË  
Dëftesë Arkëtimi

1379/1

22 OTT. 2002  
Z. A. Cepo  
22 10 2002

**K E R K E S E:** Shoqeria "ELIPS 94" shpk e perfaqesuar nga Administratore i Pergjithshme e saj Z.Namik Hajro , madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

**OBJEKT:** Prodhim ,tregtim pije alkolike dhe freskuese.Grumbullim,prodhim ,perpunim dhe tregtim te produkteve bujqesore blektorale. ne mbeshetje te Ligjit 7667 dt. 28 janar 1993.

**PERPARA: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**TIRANE**

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.8559. date 01.02.1995 eshte themeluar shoqeria "Elips 94" shpk,me otak te vetem Namik Nevruz Hajro,dhe me objekt ne fushenprojektive,ndertimeve civile deri ne dy kate,ne zbatim,punime dhe murature,betoni,b/arme ,ndertime civile,industriale,turistike bujqesore eteje.Ujsjellsa,rruge kanalizime,impiante vaditese,sisteme hidraulikee sherbim komunal si dhe import- eksport te mallrave te mallrave te ndryshme te te gjitha llojeve.Tregeti me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme.

Duke u mbeshetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortakët e shoqerise kane vendosur :

- 1.Transferimin e e kuotave te kapitalit me ane te shitjes nga Z.Hiqmet Devishi tek Namik Hajro duke mbetur ky i fundit ortak i vetem ne shoqeri.
- 2.Shtesen e objektit te veprimtarise se shoqerise nga ortaku dhe administratori i vetem i shoqerise edhe ne :*Prodhim pijesh alkollike dhe freskuese ne baze te lejes Nr.99 date 01.10.2002.*

Sa siper I kerkoje Gjykates:  
Te pranohet kerkesen per depozitim ne Regjistrin Tregtar te vendimeve te ortakëve te shoqerise "Elips -94" shpk.

- Bashkelidhur kerkeses jane:
- 1.Vendimi i Ortakëve te Shoqerise date 11.09.2002.
  - 2.Vendimi i ortakut te vetem date 18.10.2002.
  - 3.Kontrata e shitjes se kuotave Nr.1781/Rep,446/Kol date 11.09.2002.
  - 4.Vendimi Nr.8559/1,1379 date 28.07.1995.
  - 5.Vendimi i Gjykates se rrethit per regjistrimin si person juridik te shoqerise.

**KERKUESI**  
Namik Hajro

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERIS TIRANE

Nr. 1071 rep.  
Nr. 1071 kol.

**VERTETIM**

Sot me daten 29/10/2002, ne zyren e Noterise Tirane,perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht administratori i shoqerise "ELIPS-94" shpk Z.Namik Hajro i njohur personalisht prej meje i cili deklaroi se sa siper eshte deklarim i vullnetit te tij, nenshkroi aktin ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.

Noteris  
Mimoza Shehu  
Public

Shoqeria "Elips-94" shpk  
Me seli ne Korce

**V E N D I M**  
**I ASAMBLESE SE ORTAKUT**  
date 18/10/2002

Sot me daten 18/10/2002 shoqeria "Elips-94" me ortak te saj te vetem z.Namik Hajro me 100% te kuotave , banues ne Korce, regjistruar si person juridik me vendimin nr.8559 date 01.02.1995 , ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",

**V E N D O S I :**

1.Te shtoj objektin e veprimtarise se shoqerise edhe ne " Prodhim ,tregtim pije alkolike dhe freskuese.Grumbullim,prodhim ,perpunim dhe tregtim te produkteve bujqesore blektorale" sipas lejes nr. 99 date 1.10.2002, ne mbeshtetje te Ligjit 7667 dt. 28 janar 1993.

2.\*Depozitimim e kerkeses prane Gjykates se rrethit Tirane me objekt:  
shtimin e objektit te shoqerise

**Vendimi i mesiperm merret nga ortaku, bazuar ne lejen nr. 99 date 1.10.2002,neneve perkatese te statutit te shoqerise, si dhe te Ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"**

**ORTAKU I SHOQERISE**

Namik Hajro



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERIS TIRANE

Nr. 10711 rep.

Nr. 1859 kol.

**V E R T E T I M**

Sot me daten 19/10/2002, ne zyren e Noterise Tirane,perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht administratori i shoqerise "ELIPS-94" shpk Z.Namik Hajro i njohur personalisht prej meje i cili deklaroi se sa siper eshte deklarim i vullnetit te tij, nenshkroi aktin ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.



Nr. 99 prot.



Korçë 1/10/2002

**LEJE**

Nr. 99

(Profesionale dhe tekniko - teknologjike)

**GJYKATËS SË RRETHIT  
ZYRËS SË TATIMEVE**

Në Zbatim të Ligjit Nr.7941, datë 31.05.1995 "Për Ushqimin" (neni 7),  
Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.4, datë 2.12.1992 "Për fuqizimin e kontrollit  
për prodhimin, ruajtjen, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore"  
(neni 1/a dhe 1/b) dhe Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit Nr.38,  
datë 24.02 1993 ( pika 4 dhe 8), kjo Drejtori

**V E N D O S I**

1. Shoqërisë "Elops - 94" (sh.p.k), përfaqësuar  
nga Z. Namik Hajro me seli: Libënik  
dhe lokal prodhimi: Pusishkë Pijetsh  
nëpërmjet angazhimit të specialistit përkatës ushqimor Z. Gjergji Rapi  
dhe pajisjeve teknologjike të instaluar, t'i jepet

**LEJA E AFTËSISË PROFESIONALE DHE TEKNIKO - TEKNOLOGJIKE  
PËR PRODHIM**

Pije alkoolike + freskues

2. Leja është e vlefshme për periudhën një vjeçare nga e dhënies dhe përsëritet çdo vit.

INSPEKTORIATI I USHQIMIT

DREJTORI

Alben Gjata

Besnik Sigurdiani

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE POGRADEC

Nr. 4781 ..... Rëp

Nr. 446 ..... Kol



**KONTRATE SHITJEJE**  
**KUOTASH DHE KAPITALESH**

Sot me date 11/9/2002 (dymije e dy), ne Zyren e Noterise Pogradec, u paraqiten personalisht para meje, Noterit **Stavri Ruvina**, ortaket e SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELIPS 94" sh.p.k Korçe :

**1. Hiqmet DERVISHI**, i biri i Bexhet, i datelindjes 1956, banues ne Pogradec, madhor me zotesi te plote juridke dhe per te vepruar, identifikar me pasaporte Nr. 0877757, me cilesine e pales **SHITесе**.

**2. Namik HAJRO**, i biri i Nervus, i datelindjes 1952, banues ne Libonik te rrethit Korçe, madhor me zotesi te plote juridke dhe per te vepruar, identifikuar me paaporte Nr. —, me cilesine e pales **BLERесе**.

**te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitjeje :**

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. **8559/1** \_\_\_\_\_, date **28.07 1995** eshte vendosur qe SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELIPS 94" sh.p.k Korçe , do te kete **dy** ortake me kontributin e perbashket te kapitalit prej **50%** sejcili.

Ne baze te Vendimit te Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie , date 11 Shtator 2002, Hiqmet DERVISHI ja shet te gjithe pjesen e kapitalit te tij prej **50%** qe ka ne kete shoqeri, ortakut tjeter **z. Namik HAJRO** me çmimin **50.000** (pesedhjet mije ) leke te reja.

Me ndryshimin e mesiperm, ortaku i shoqerise "ELIPS94 " Sh.P.K, Korçe, Hiqmet DERVISHI, pjesen e tij te kuotave ne kete shoqeri ja transferon Z. Namik HAJRO, i cili qe nga ky moment behet ortaku i vetem i shoqerise "ELIPS 94 " Sh.P.K Korçe, duke zoteruar ne kete menyre **100 %** te kuotave.

Pas nenshkrimimit te kesaj kontrate, shitesi **Hiqmet DERVISHI** humbet çdo te drejte pronesie dhe te drejte reale mbi Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "ELIPS 94" Sh.P.K, Korçe.

Ortak i vetem i shoqerise "ELIPS 94 " Sh.P.K, Korçe behet **Z. Namik HAJRO**.

Persa me siper u perpilua prej meje noterit kjo kontrate ne kater kopje me fuqi te njejta ligjore, te cilat pasi u lexuan dhe u gjeten sipas vullnetit te paleve, nenshkruhet prej tyre sipas ligjit dhe vertetoihen prej mej rregullisht.

SHITESI

Hiqmet Dervishi

BLERESI

Namik Hajro

NOTERI

**Stavri F. RUVINA**

Korçe, me 11/9/2002

**V E N D I M**  
**I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE ORTAKVE**

Sot me date 11/9/2002 ne, ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ELIPS 94" sh.p.k Korçe, **Namik HAJRO** dhe **Hiqmet DERVISHI** ne mbledhjen e jashtezakonshme te bere me kerkesen e te dy ortakëve pasi shqyrtuan çeshtjen

**V E N D O S E M :**

1. Ne baze te Nenit 33 dhe ne mbeshtetje te ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 "per shoqerite Tregtare dhe Nenit 3/6 te Statutit te Shoqerise ,z. Hiqmet DERVISHI terhiqet nga shoqeria "ELIPS 94" sh.p.k Korçe.

2. **Z. HIQMET DERVISHI**, pjesen e vet te kapitalit qe ka ne kete shoqeri prej 50%(pesedhjet perqind) te kapitalit fillestar dhe te aktivitetit ekonomik qe kane zhvilluar, ja shtet ortakut tjeter z.Namik HAJRO me çmimin **50.000**(pesedhjet mijë) leke te reja sipas vleres se kontributit ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Shitja do te behet me Kontrate-Shitjeje para Noterit, e cila do t'i bashkangjitet ketij vendimi.

3. Z. Hiqmet DERVISHI me nenshkrimin e Kontrates se Shitjes çvishet tersisht nga pronesia mbi kapitalin e shoqerise dhe si rrjedhim dhe nga çdo e drejte apo detyrim ndaj shoqerise "ELIPS 94" sh.p.k Korçe.

4. Shoqerise "ELIPS" sh.p.k Korçe me largimin e ortakut z.Hiqmet DERVISHI, ngelet shoqeri me nje ortak te vetem dhe administrator **z.Namik HAJRO**.

**ORTAKET**  
**E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"ELIPS" sh.p.k Korçe**

1. Hiqmet DERVISHI  
*Hiqmet Dervishi*

2. Namik HAJRO  
*Namik Hajro*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE POGRADEC  
Nr. 1782 ..... Rep  
Nr. 687 ..... Kol



**V E R T E T I M**

Sot me date 11/9/2002, ne Zyren e Noterise Pogradec, u paraqiten personalisht para meje ortaket e SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELIPS 94" sh.p.k Korçe :

1. **Namik Hajro**, i biri i Nevrus, i datelindjes 1952, banues ne Libonik te rrethit Korçe, identifikuar me pasaporte Nr. \_\_\_\_\_.

2. **Hiqmet Dervishi**, i biri i Bexhet, i datelindjes 1956, banues ne Pogradec, identifikuar me pasaporte Nr. 0877757

madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, te cilet me deklaruan se Vendimi i mesiperm eshte nenshkruar prej tyre sipas vullnetit te lire e te plote dhe une noteri e nenshkrova ate ne baze te ligjit .

**NOTERI**

**Stavri F. RUVINA**

*Stavri F. Ruvina*